



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 10 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihour

Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së parashtruesve të
kërkesave të refuzuara**
Ani Pues

Mbrojtëses të Krasniqi
Venkatesvari Alagendra

Panelit të Gjykatës së Apelit

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	4
	A. Parashtrimi i kërkesës dhe pranimi në proces	4
	B. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	6
	C. Masat mbrojtëse	Error! Bookmark not defined.
III.	DISKUTIM	7
	A. Kërkesat për të cilat në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave është shtyrë marrja e vendimit	8
	1. Viktima 12/06	8
	2. Viktima 05/06	9
	B. Kërkesat e dorëzuara me Shtesën e Dytë të Raportit të Parë të Zyrës Administrative dhe me Raportin e Dytë të Zyrës Administrative	13
	1. Plotësia e kërkesave	13
	2. Pranueshmëria e kërkesave	14
	3. Përfundim	Error! Bookmark not defined.
	C. Masat mbrojtëse	17
	1. Parashtruesit e kërkesave të pranuar	17
	2. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara	20
	D. Ndarja në grupe dhe përfaqësimi ligjor i përbashkët	20
	E. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	21
	F. Arsyetim i mëtëjshëm për vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për refuzimin e kërkesave të parashtruesve të refuzuar	21
	1. Vërejtje paraprake	21
	2. Arsyetim i mëtëjshëm	23
IV.	VENDIM	Error! Bookmark not defined.

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 22, 39(11) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 80, 95(2)(h) dhe (i), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (“Aktakuza e Konfirmuar”).²
2. Më 5 janar 2021 dhe 6 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori dy vendime kornizë që përcaktonin parimet që rregullojnë procesin e pranimit të viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor në çështjen aktuale.³
3. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”, duke pranuar nëntë viktima si pjesëmarrëse në proces, duke refuzuar shtatë dhe duke shtyrë për më vonë marrjen e vendimit për

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u nxor më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED, dhe versioni i redaktuar publik më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Aktakuza e konfirmuar u dorëzua më 30 tetor 2020; shih KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidenciale, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Versioni i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar, në të cilin u korrigjuan disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, F00045/A01 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*), F00045/A02 (version konfidencial i redaktuar) dhe F00045/A03 (version i redaktuar publik). Një version konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 11 dhjetor 2020, F00134.

³ KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat (“Vendimi i Parë Kornizë”)*, 4 janar 2021, publik; F00382, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 6 korrik 2021, publik.

një viktimë, viktimën 12/06.⁴ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi të shqyrtonte kërkesën e një viktime, viktimës 05/06, që sipas Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave (“ZPV”) kishte ndërruar jetë pas dorëzimit të kërkesës së tij.⁵

4. Më 21 maj 2021 dhe 11 qershor 2021, ZPV-ja dorëzoi informacion shtesë përkatësisht në lidhje me viktimat 12/06 dhe 05/06.⁶ Gjithashtu, ZPV-ja dorëzoi një kërkesë të bërë nga viktimja 26/06, një anëtar i familjes së viktimës 05/06, i cili dëshironte: (i) të vazhdonte me kërkesën e viktimës 05/06 si pasardhës dhe (ii) të merrte pjesë vetë si viktimë e tërthortë (“Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative”).⁷ Palët nuk parashtruan vërejtje në përgjigje të parashtrimeve të ZPV-së në lidhje me viktimat 05/06 dhe 26/06.

5. Më 18 qershor 2021, ZPV-ja dorëzoi një raport të dytë në lidhje me kërkesat e viktimave, duke dorëzuar 11 kërkesa të reja (“Raporti i Dytë i Zyrës Administrative”).⁸ Palët nuk parashtruan vërejtje ndaj raportit.

6. Më 16 korrik 2021, pas apelit të paraqitur nga gjashtë prej shtatë parashtruesve, kërkesat e të cilëve ishin refuzuar me Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (“Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara”),⁹ paneli i

⁴ KSC-BC-2020-06, F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 21 prill 2021, konfidencial, para. 85(a), (e), (f). Versioni i redaktuar publik u nxor në të njëjtën ditë, F00257/RED.

⁵ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 14, 35.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00318, ZPV, *Parashtrim i Zyrës Administrative në Pajtim me Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Informacion Shtesë për Viktimën 12/06”), 21 maj 2021, konfidencial; F00347, ZPV, *Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces* (“Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative”), 11 qershor 2021, publike, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 12.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00360, ZPV, *Raporti i Dytë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces* (“Raporti i Dytë i Zyrës Administrative”), 18 qershor 2021, publik, më Shtojcat 1-12, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ Viktimat 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06. Viktimja 06/06 e pranoi vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe nuk e apeloj atë; shih KSC-BC-2020-06, IA005/F00004/RED, *Version i Redaktuar Publik i Apelit kundër “Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” në Pajtim me Rregullën 113(6) të Rregullores*, 7 qershor 2021, publik, para. 1.

Gjykatës së Apelit udhëzoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake t'i rikthehej vendimit duke bërë një vlerësim individual të kërkesave dhe treguar arsyet në të cilat mbështetej vendimi i tij për refuzimin e tyre.¹⁰

7. Më 20 gusht 2021, mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të refuzuara paraqiti parashtrimet e saj në lidhje me dëmin që kishin pësuar parashtruesit e kërkesave të refuzuara dhe kërkoi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të rishqyrtonte vendimin e tij për refuzimin e kërkesave të tyre.¹¹

8. Më 3 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar").¹²

9. Më 19 nëntor 2021, ZPV-ja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se një nga viktimat që kishte parashtruar kërkesë, viktimja 35/06, dëshironte të tërhiqte kërkesën e vet.¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES

10. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores, viktimja është person fizik që ka pësuar personalisht dëm fizik, mendor apo material, si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara

¹⁰ KSC-BC-2020-06, IA005/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin kundër "Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"* ("Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 16 korrik 2021, publik, para. 40-41.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00436, Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, *Parashtrime në lidhje me Kërkesat Individuale të Viktimave të Refuzuara* ("Parashtrime të Mbrojtëses së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara"), 20 gusht 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, f. 6.

¹² KSC-BC-2020-06, F00455/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesa për Ndryshim në Pajtim me Rregullën 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara publike dhe konfidenciale u dorëzuan më 8 shtator 2021, përkatësisht F00455/CONF/RED/A01 dhe F00455/RED/A01.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00573, ZPV, *Tërheqje e Kërkesës për Pjesëmarrje në Proces nga Viktimja Parashtruese - 35/06*, 19 nëntor 2021, publike.

dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

11. Sipas rregullës 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve.

12. Sipas rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon ato Gjykatësit të Procedurës Paraprake së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe kërkesën për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. ZPV-ja duhet t'u dorëzojë edhe një raport konfidencial palëve, pa nxjerrë të dhëna identifikuese të parashtruesve të kërkesave.

13. Sipas rregullës 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

14. Sipas rregullës 95(2)(i) dhe 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos edhe për përfaqësimin e përbashkët, si dhe për çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

15. Sipas rregullës 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh pas njoftimit.

16. Sipas rregullës 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pasi konsultohet me ZPV-në, vendos nëse viktimat pjesëmarrëse në proces do të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh: (a) konfliktet e interesave që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët; (b) interesat e ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe (c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat për një gjykim të drejtë e të shpejtë.

B. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

17. Në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe të drejtat e viktimave në procese penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

18. Në pajtim me rregullën 113(7) të Rregullores, kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, grupit të VPP-ve Administratori i cakton një mbrojtës të viktimave në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.

19. Në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(1) të Rregullores, VPP-të i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një mbrojtësi të viktimave të caktuar, ndër të tjera gjatë procedurës paraprake, kur preken interesat personale të VPP-ve dhe vetëm kur kjo nuk cenon apo nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.

20. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e VPP-ve në procedurën paraprake, në pajtim me nenin 22(3) dhe (6) të Ligjit.

21. Në pajtim me rregullën 114(2) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtave të VPP-ve, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

22. Në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe, ose sipas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.

23. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të VPP-ve dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues, bën parashtrime me gojë dhe me shkrim.

C. MASAT MBROJTËSE

24. Në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit dhe rregullën 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve, të paraqitura përpara kalimit të dosjes gjyqësore trupit gjykues.

25. Në pajtim me nenin 80(1) të Rregullores, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë, ndër të tjera, të viktimave pjesëmarrëse në procese.

26. Në pajtim me rregullën 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët të materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.

III. DISKUTIM

27. Në këtë vendim Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) do të vendosë në lidhje me kërkesat e viktimave 12/06 dhe 05/06, marrja e vendimit në lidhje me të cilat ishte shtyrë për më vonë në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave;

(b) do të vendosë në lidhje me kërkesat e dorëzuara me Shtesën e Dytë të Raportit të Parë të Zyrës Administrative dhe me Raportin e Dytë të Zyrës Administrative; dhe

(c) do të japë arsye të mëtjshme në lidhje me vendimin e tij për refuzimin e kërkesave të parashtruesve të refuzuar.

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në “Vendimin e Parë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat” (“Vendimi i Parë Kornizë”) dhe në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave lidhur me: kriteret që një kërkesë të konsiderohet e plotë,¹⁴ kriteret e pranueshmërisë,¹⁵ standardin e vërtetimit,¹⁶ kriteret ligjore që zbatohen për miratimin e masave mbrojtëse¹⁷ dhe kriteret për ndarjen në grupe të viktimave për përfaqësimin e përbashkët ligjor.¹⁸

A. KËRKESAT PËR TË CILAT NË VENDIMIN E PARË MBI PJESËMARRJEN E VIKTIMAVE ISHTE SHTYRË MARRJA E VENDIMIT

1. Viktima 12/06

29. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, ai konstatoi se krimi i pretenduar nga viktima 12/06 nuk

¹⁴ Vendimi i Parë Kornizë, para. 22; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 34.

¹⁵ Vendimi i Parë Kornizë, para. 28, 30-39; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42, 45, 50-55.

¹⁶ Vendimi i Parë Kornizë, para. 29; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43.

¹⁷ Vendimi i Parë Kornizë, para. 45-49; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 64, 67.

¹⁸ Vendimi i Parë Kornizë, para. 42-44; *shih gjithashtu* para. 27, 40-41, 44, 49, lidhur me rolin e ZPV-së që bën vlerësimin paraprak në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave, ndarjen në grupe të parashtruesve të kërkesave dhe masat mbrojtëse të kërkuara; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76.

përfshihej qartazi brenda kuadrit [REDAKTUAR], siç përcaktohet në Aktakuzën e Konfirmuar, por ishte e paqartë nëse ai mund të përfshihej brenda kuadrit të akuzave [REDAKTUAR] në të njëjtën vendndodhje.¹⁹ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se kuadri i akuzave [REDAKTUAR] [REDAKTUAR].²⁰ Anëtari i familjes së viktimës 12/06 nuk është [REDAKTUAR].²¹ Sa i përket akuzave [REDAKTUAR], Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, sipas viktimës 12/06, anëtari i familjes së tij nuk ishte [REDAKTUAR] ndonjëherë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ("UÇK").²² Rrjedhimisht, edhe krimi i pretenduar nga viktima 12/06 nuk përfshihet brenda [REDAKTUAR].

30. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se krimi, viktimë e të cilit pretendon se ka qenë viktima 12/06, nuk përfshihet brenda kuadrit material të akuzave të përcaktuara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar. Rrjedhimisht, viktima 12/06 nuk përfshihet brenda fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores. Kjo nuk cenon asnjë vendim të ardhshëm sa i takon pranueshmërisë së kërkesës së tij, përfshirë edhe në lidhje me dëmin që mund të ketë pësuar si pasojë e krimit të përshkruar, pas ndonjë ndryshimi të mundshëm të Aktakuzës së Konfirmuar të Korrigjuar.

2. Viktima 05/06

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, pas paraqitjes së kërkesës së tij, viktima 05/06 ndërroi jetë. Viktima 26/06, i cili është anëtar i familjes së ngushtë, dëshiron të vazhdojë me kërkesën e viktimës 05/06 si pasardhës.²³ Rrjedhimisht, Gjykatësit të Procedurës Paraprake i duhet të vendosë nëse kërkesa e parashtruar

¹⁹ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 47.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës* ("Vendimi në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës"), 22 korrik 2021, konfidencial, [REDAKTUAR]. Versioni i redaktuar publik u nxor po atë ditë, F00413/RED; Vendimi mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24.

²¹ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 47 dhe poshtëshënimi 54; [REDAKTUAR].

²² Informacion Shtesë për Viktimën 12/06, para. 5; Viktima 12/06, Shënimi në Dosje SD-8 – Informacioni Shtesë.

²³ Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 12.

nga një viktimë që ka ndërruar jetë para përfundimit të procesit mund të vazhdohet nga një person tjetër në emër të viktimës së ndjerë.

(a) Vazhdimi me kërkesën në emër të viktimës së ndjerë

32. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ky aspekt nuk është trajtuar shprehimisht në Ligj apo në Rregullore. Megjithatë, neni 22(3) i Ligjit parashikon që në proceset para Dhomave të Specializuara, viktimat kanë të drejtën e njoftimit, pranimit dhe zhdëmtimit. E drejta e pranimit kuptohet si e drejtë për njohjen e dëmit të pësuar.²⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është e domosdoshme të mbrohet kjo e drejtë²⁵ dhe, rrjedhimisht, t'u mundësohet të afërmeve të viktimave të ndjera ose individëve të lidhur ngushtë me to, që të vazhdojnë me kërkesën për pjesëmarrje në proces të parashtruar fillimisht nga viktima. Për të vazhduar me kërkesën e parashtruar fillimisht nga viktima, të afërmit ose personat me lidhje të ngushta me të duhet të paraqesin prova për (i) vdekjen e viktimës, dhe (ii) lidhjen e tyre familjare me viktimën. Duke qenë se ata do të vazhdojnë me kërkesën e parashtruar fillimisht nga viktima e ndjerë, në kërkesën e tyre, ata mund ta bëjnë këtë vetëm brenda kuadrit të parashtrimeve të bëra nga viktima.²⁶

²⁴ Shih KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykoës I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, publik, para. 16.

²⁵ Shih neni 3(2) i Ligjit dhe neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²⁶ Shih, në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-1052, Trial Chamber I, [Decision on the Resumption of Action Applications](#), 11 October 2017, paras 12-14; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-962, Trial Chamber IX, [Decision on LRV Request Concerning the Deaths of Participating Victims](#), 30 August 2017, para. 3; *Prosecutor v. Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-3346, Trial Chamber III, [Decision on "Requête relative à la reprise des actions introduites devant la Cour par des victimes décédées"](#), 24 March 2016, para. 22; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-805, Trial Chamber VI, [Fourth Decision on Victims' Participation in Trial Proceedings](#), 1 September 2015, para. 8; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-1737, Trial Chamber II, [Motifs de la deuxième décision relative aux demandes de participation de victimes à la procédure](#), 22 December 2009, paras 30-32. Shih gjithashtu *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-37-tENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision Establishing the Principles Applicable to Victims' Applications for Participation](#), 24 May 2018, para. 52; *Prosecutor v. Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-320, Pre-Trial Chamber III, [Fourth Decision on Victims' Participation](#), 12 December 2008, paras 44, 47.

33. Pasi ka përcaktuar se kërkesa e parashtruar nga viktimja 05/06 mund të vazhdohet nga një i afërm ose person me lidhje të ngushta me të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar nga viktimja 05/06 i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe nëse viktimja 26/06 i përmbush kriteret si i afërm ose si person me lidhje të ngushtë me të.

(b) Plotësia e kërkesës

34. Pas shqyrtimit të formularit të kërkesës së viktimës 05/06 dhe dokumentacionit mbështetës sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Parë Kornizë,²⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se kërkesa është e plotë.²⁸

(c) Pranueshmëria e kërkesës

35. *Person fizik*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se viktimja 05/06 ishte person fizik.²⁹

36. *Krimet e pretenduara*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimja 05/06 është viktimë e krimeve (burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, akte të tjera çnjerëzore, trajtim mizor, torturë dhe përndjekje) të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe të kryera në një nga qendrat e ndalimit të përmendura në të, [REDAKTUAR], dhe krimet e pretenduara përfshihen brenda kuadrit kohor të akuzave që lidhen me këtë vendndodhje.³⁰

²⁷ *Shih* Vendimi i Parë Kornizë, para. 22.

²⁸ *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00203, ZPV, *Raporti i Parë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces* ("Raporti i Parë i Zyrës Administrative"), 15 shkurt 2021, publik, me Shtojcat 1-19, konfidenciale dhe *ex parte*, para. 13-14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ndonëse dokumentacioni në lidhje me dëmin e pësuar nuk është dorëzuar, përshkrimi i hollësishëm i bërë nga viktimja 05/06 është i mjaftueshëm për të bërë konstatimet përkatëse.

²⁹ *Shih* Raporti i Parë i Zyrës Administrative, para. 22; Viktimja 05/06, SD2, SD3.

³⁰ *Shih* Raporti i Parë i Zyrës Administrative, para. 38; Shtojca 6 e Raportit të Parë të Zyrës Administrative; Viktimja 05/06, Formulari i kërkesës_ANG; SD1_Paraqitja e krimeve_ANG; Versioni i Korrigjuar i Aktakuzës së Konfirmuar, [REDAKTUAR].

37. *Dëmi*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se viktimja 05/06 ka pësuar dëm fizik, si lëndime të rënda trupore, plagë, gjymtim dhe dëmtim trupor, dhe dëm mendor, si frikë dhe stres emocional, si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të përfshira në aktakuzë, viktimë e të cilave pretendohet se ka qenë.³¹ Megjithatë, informacioni i dhënë në lidhje me shkatërrimin dhe konfiskimin e pretenduar të pronës nuk mjafton për një konstatim *prima facie* se viktimja 05/06 ka pësuar edhe dëm material, si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të përfshira në aktakuzë, siç pretendohet.³² Ky konstatim nuk cenon asnjë vendim të ardhshëm pas dorëzimit të materialit shtesë për këtë aspekt.

(d) Nëse viktimja 26/06 mund të vazhdojë me kërkesën për pranim si VPP, të parashtruar fillimisht nga viktimja 05/06

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se është dorëzuar certifikata e vdekjes së viktimës 05/06³³ dhe viktimja 26/06 është [REDAKTUAR] i viktimës 05/06.³⁴ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimja 26/06 mund të vazhdojë me kërkesën për pranim si VPP, të parashtruar fillimisht nga viktimja 05/06.

(e) Përfundim

39. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake (i) është i bindur se ka prova *prima facie* se viktimja 05/06 ka pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe konstaton se kërkesa e tij është e pranueshme; dhe (ii) vendos që viktimja 26/06

³¹ *Shih* Raporti i Parë i Zyrës Administrative, para. 38; Viktimja 05/06, Formulari i kërkesës_ANG; SD1_Paraqitja e krimev_ANG, f. 9; SD5-Shënim në dosje.

³² Viktimja 05/06, Formulari i kërkesës_ANG.

³³ Viktimja 05/06, SD6. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ZPV-ja nuk ka dorëzuar përkthimin në gjuhën angleze të certifikatës së vdekjes. Për hir të efikasitetit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë konstatimin e tij mbi bazën e certifikatës të lëshuar në gjuhën origjinale. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në që në të ardhmen të dorëzojë përkthime në gjuhën angleze.

³⁴ Viktimja 26/06, Formulari i kërkesës; përkthimi ANG; SD2.

mund të vazhdojë me kërkesën për pranim si VPP para Dhomave të Specializuara, të parashtruar fillimisht nga viktimat 05/06.

B. KËRKESAT E DORËZUARA ME SHITESËN E DYTË TË RAPORTIT TË PARË TË ZYRËS ADMINISTRATIVE DHE ME RAPORTIN E DYTË TË ZYRËS ADMINISTRATIVE

40. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh dëshirën e viktimës 35/06 për t'u tërhequr³⁵ dhe nuk do ta shqyrtojë më tej kërkesën e tij.

41. Në vijim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë kërkesat e viktimave 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPV-ja rekomandon që të gjithë parashtruesit e kërkesave të pranohen si viktimat pjesëmarrëse në proces.³⁶

1. Plotësia e kërkesave

42. Pas shqyrtimit të formularëve të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës sipas kriterëve të përcaktuar në Vendimin e Parë Kornizë,³⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se të gjitha kërkesat janë të plota.³⁸

³⁵ KSC-BC-2020-06, F00573, ZPV, *Tërheqje e Kërkesës për Pjesëmarrje në Proces nga Viktimat Parashtruese - 35/06*, 19 nëntor 2021, publike.

³⁶ Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 22; Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 37.

³⁷ *Shih* Vendimi i Parë Kornizë, para. 22.

³⁸ *Shih gjithashtu* Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 14; Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ndonëse dokumentacioni në lidhje me dëmin e pësuar nuk është dorëzuar nga viktimat 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06 dhe 40/06, përshkrimet e hollësishme të bëra nga parashtruesit e kërkesave janë të mjaftueshme për të bërë konstatimet përkatëse.

2. Pranueshmëria e kërkesave

43. *Persona fizikë*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se të gjitha viktimat parashtruese të kërkesave për pjesëmarrje në proces janë persona fizikë.³⁹

44. *Krimet e pretenduara*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se të gjithë parashtruesit e kërkesave janë viktima të krimeve të paraqitura në akuza të lidhura me vendndodhjet e identifikuara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe të cilat përfshihen brenda kuadrit kohor të akuzave që lidhen me këto vendndodhje, si vijon:

(a) **Viktima 20/06** është viktimë e tërthortë e krimeve që pretendohet se janë kryer në [REDAKTUAR] (vrasje e paligjshme), ndaj një anëtari të familjes së ngushtë i cili përmendet me emër si viktimë në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar;⁴⁰

(b) **Viktima 22/06** është viktimë e krimeve që pretendohet se janë kryer në [REDAKTUAR] (burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar dhe përndjekje) ndaj një anëtari të familjes së ngushtë.⁴¹ Duke vënë në dukje se viktima 22/06 pretendon gjithashtu se fati i anëtarit të familjes së saj mbetet i panjohur edhe sot e kësaj dite,⁴² Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se kuadri i akuzës për zhdukje me forcë kufizohet në incidentet konkrete të përshkruara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe në viktimat e

³⁹ *Shih* Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 14; Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 20; Viktima 20/06, SD1, SD2; Viktima 22/06, SD1; Viktima 26/06, SD1, SD2; Viktima 33/06, SD1, SD2; Viktima 34/06, SD1, SD2; Viktima 36/06, SD1; Viktima 37/06, SD1; Viktima 38/06, SD1; Viktima 39/06, SD1; Viktima 40/06, SD1, SD3; Viktima 41/06, SD1, SD2.

⁴⁰ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 33; Shtojca 2 e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 20/06, Formulari i kërkesës_ANG; Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar [REDAKTUAR].

⁴¹ *See* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 34; Shtojca 3 e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 20/06, Formulari i kërkesës_ANG; SD3_Paraqitja e krimeve_ANG; Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, [REDAKTUAR].

⁴² Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 34; Viktima 22/06, Formulari i kërkesës_ANG; SD3_Paraqitja e krimeve_ANG.

identifikuara në të dhe në Listën C.⁴³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se familjari i viktimës 22/06 nuk është ndër viktimat e përmendura me emër dhe, për rrjedhojë, nuk përfshihet brenda kuadrit të akuzës për zhdukje me forcë të përcaktuar në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar;

(c) **Viktima 26/06** është viktimë e tërthortë e krimeve që pretendohet se janë kryer ndaj viktimës 05/06.⁴⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të tij të mësipërme në lidhje me viktimën 05/06;⁴⁵

(d) **Viktimat 33/06, 34/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06** janë të gjithë anëtarë të të njëjtës familje dhe janë viktima të tërthorta të krimeve që pretendohet se janë kryer ndaj një të afërmi (përndjekje, burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, akte të tjera çnjerëzore, trajtim mizor, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) i cili përmendet me emër në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe në Përmbledhjen sipas rregullës 86(3)(b);⁴⁶ dhe

(e) **Viktimat 36/06,⁴⁷ 37/06 dhe 38/06** janë viktima të drejtpërdrejta të krimeve (burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, akte të tjera

⁴³ Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, para. 171, që, ndër të tjera, i referohet [REDAKTUAR]; Vendimi mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendimi në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 171.

⁴⁴ *Shih* Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative, para. 12, 15; Viktima 26/06, Formulari i kërkesës për kthimi në anglisht.

⁴⁵ *Shih* para. 36 më lart.

⁴⁶ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 35; Shtojcat 4, 5, 10-12 të Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 33/06, Formulari i kërkesës, SD5; Viktima 34/06, Formulari i kërkesës, SD6; Viktima 39/06, Formulari i kërkesës; Viktima 40/06, Formulari i kërkesës; Viktima 41/06, Formulari i kërkesës, SD3; Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar; Listat A, B, C; KSC-BC-2020-06, F00006/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Kërkesës për Paraqitjen e Materialit Mbështetës Shtesë* ("Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b)"), 2 korrik 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 11 dhjetor 2020, KSC-BC-2020-06, F00136/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Përmbledhjeve të Redaktuara Konfidenciale sipas Rregullës 86(3)(b)*, 11 dhjetor 2020, konfidenciale.

⁴⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se viktima 36/06 pretendon se ishte arrestuar dhe ndaluar diku në vitin 1999, pa dhënë një datë apo kornizë kohore më konkrete. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se [REDAKTUAR] dhe se ai vetë përmendet me emër si viktimë në Përmbledhjen sipas rregullës 86(3)(b) (*shih* Viktima 36/06, Formulari i kërkesës, SD2, f. 1). Rrjedhimisht, Gjykatësi i

çnjerezore, trajtim mizor, torturë dhe përndjekje) dhe ato përmenden me emër si viktimë në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b).⁴⁸

45. *Dëmi*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se të gjitha viktimat kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të pretenduara të përshkruara prej tyre, si më poshtë:

(a) **Viktimat 36/06, 37/06 dhe 38/06** kanë pësuar dëm fizik (si prerje, mavijosje, lëndime dhe thyerje të krahëve, gishtave dhe dhëmbëve), dëm mendor (si çrregullime të stresit pastraumatik, humbje kujtese dhe probleme me gjumin) dhe dëm material (humbje të të ardhurave) si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit dhe keqtrajtimit të tyre të pretenduar;⁴⁹

(b) **Viktimat 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06 dhe 40/06** kanë pësuar dëm mendor (si trauma psikologjike, depresion, ankth, hidhërim të thellë, frikë, probleme me gjumin dhe stres),⁵⁰ duke qenë anëtarë të familjes së ngushtë të viktimave të drejtpërdrejta;⁵¹ dhe

(c) **Viktimat 39/06 dhe 41/06**, kanë pësuar dëm mendor për shkak të marrëdhënies së ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë.⁵² Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktimat 39/06 dhe 41/06

Procedurës Paraprake është i bindur se krimet, viktimë e të cilave ai pretendon të jetë, përfshihen brenda kuadrit kohor të akuzave.

⁴⁸ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 36; Shtojcat 7, 8 dhe 9 të Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 36/06, Formulari i kërkesës, SD2; Viktima 37/06, Formulari i kërkesës, SD2; Viktima 38/06, Formulari i kërkesës, SD1; Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar; Përmbledhja sipas Rregullës 86(3)(b).

⁴⁹ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 25, 26, 32, 36; Viktima 36/06, Formulari i kërkesës; Viktima 37/06, Formulari i kërkesës; Viktima 38/06, Formulari i kërkesës.

⁵⁰ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 25, 27, 30, 31-35; Viktima 20/06, Formulari i kërkesës_ANG; Viktima 22/06, Formulari i kërkesës_ANG; Viktima 26/06, Formulari i kërkesës përkthimi në anglisht; Viktima 33/06, Formulari i kërkesës; Viktima 34/06, Formulari i kërkesës; Viktima 40/06, Formulari i kërkesës.

⁵¹ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50, 53.

⁵² *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50, 53; Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 25, 27, 30-32, 35.

janë të afërm të viktimës së drejtpërdrejtë [REDAKTUAR].
[REDAKTUAR].⁵³

46. Konstatimet e mësipërme nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm pas dorëzimit të materialit shtesë.

3. Përfundim

47. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka prova *prima facie* se viktimat 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe i pranon si viktimë pjesëmarrëse në proces.

C. MASAT MBROJTËSE

1. Parashtruesit e kërkesave të pranuar

48. ZPV-ja rekomandon që për viktimat 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 të miratohet mosnxjerrja e identiteteve të tyre për publikun, të akuzuarit dhe mbrojtësit⁵⁴ dhe për viktimën 05/06 të miratohet mosnxjerrja e identitetit të tij për publikun.⁵⁵

(a) Formularët e kërkesës

49. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës duhet të vazhdojnë të mbajnë klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.⁵⁶

⁵³ Shtojca 10 e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktimë 39/06, SD3; Viktimë 41/06, Formulari i kërkesës, SD3.

⁵⁴ Shtesa e Dytë e Raportit të Parë, para. 51; Raporti i Dytë të Zyrës Administrative, para. 48.

⁵⁵ Raporti i Parë të Zyrës Administrative, para. 61.

⁵⁶ *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 64.

(b) Identiteti i parashtruesve të kërkesave

50. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, siç vihet në dukje në Vendimin e Parë Kornizë, kriteret ligjore që zbatohen për masat mbrojtëse në lidhje me viktimat janë të njëjta me ato që zbatohen në lidhje me dëshmitarët.⁵⁷ Pavarësisht nga kjo, në marrjen e masave të duhura mbrojtëse në lidhje me viktimat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se: (i) qëllimi i pjesëmarrjes së viktimave në proces është që t'u mundësojë atyre realizimin e të drejtave dhe interesave personale në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren; dhe (ii) një qëllim i tillë duhet mbajtur parasysh edhe në lidhje me masat mbrojtëse që duhen urdhëruar për viktimat, pa cenuar asnjë masë tjetër shtesë që rrjedh nga statusi i dyfishtë i mundshëm i tyre.⁵⁸ Konstatimet e mëposhtme nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm të trupit gjykues përkatës në lidhje me këtë aspekt.

51. Për vlerësimin e ekzistencës së rrezikut objektivisht të arsyetueshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktorët konkretë të mëposhtëm që janë të zbatueshëm për një ose më shumë prej viktimave: (i) të gjitha viktimat vazhdojnë të vuajnë nga trauma fizike dhe/ose mendore si rezultat i krimeve, viktimë e të cilave pretendohet se kanë qenë ata ose familjarët e tyre; (ii) të gjitha viktimat kanë shprehur shqetësimin se nxjerrja e identiteteve të tyre për publikun, mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit mund t'i rrezikojë ata ose familjet e tyre; dhe (iii) [REDAKTUAR].⁵⁹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr në konsideratë: (i) atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave që mbizotëron në Kosovë, sidomos në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së; dhe (ii) mjetet dhe motivet e të akuzuarve për t'i frikësuar viktimat, po të merren parasysh postet me pushtet që kanë mbajtur gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat, si dhe kohët e fundit.⁶⁰

⁵⁷ Vendimi i Parë Kornizë, para. 47.

⁵⁸ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67.

⁵⁹ *Shih* Formularët e kërkesës të secilës prej viktimave.

⁶⁰ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68.

Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) për shkak të statusit të tyre si viktimë pjesëmarrëse në proces, këta individë janë veçanërisht të cenueshëm dhe çdo masë mbrojtëse do të duhej t'u jepte përgjigje nevojave të tyre të veçanta si viktimë; dhe (ii) masat adekuate mbrojtëse për viktimat shpesh janë mjete juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces, sepse masa të tilla janë një hap i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e viktimave në pajtim me rregullën 80 të Rregullores.⁶¹

52. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se nxjerrja për publikun dhe për palët e çdo materiali apo informacioni që çon në identifikimin e VPP-vë të pranuar përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për to dhe për familjarët e tyre dhe, rrjedhimisht, konstaton se në këtë fazë të procesit anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është masa më e përshtatshme dhe e nevojshme.

53. Sa i takon proporcionalitetin të këtyre masave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, çdo masë mbrojtëse e urdhëruar në lidhje me një viktimë pjesëmarrëse të pranuar në fazën e tanishme të procesit, nuk pengon ndryshimin e masave të tilla në një fazë të mëvonshme, përfshirë edhe nga trupi gjykues, nëse lind nevoja dhe kur të lindë kjo nevojë.⁶² Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në këtë fazë të procesit, anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është një masë proporcionale.

54. Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave 05/06, 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 të mos u bëhen të ditura publikut dhe palëve.

⁶¹ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68.

⁶² *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 69.

2. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara

55. Sa i takon viktimës 12/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se në bazë të rregullës 113(1)-(2) të Rregullores, procesi i paraqitjes së kërkesave është konfidencial dhe gjykon se mosnxjerrja për palët dhe publikun e emrit dhe të dhënave identifikuese të viktimës 12/06, është e domosdoshme për të mbrojtur privatësinë e tij. Duke pasur parasysh se ai nuk është pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proces, mosnxjerrja e identitetit të tij nuk cenon të akuzuarit apo gjykimin e drejtë.⁶³

56. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emri dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimës 12/066 të mos u bëhet e ditur palëve dhe publikut. Rrjedhimisht, edhe formulari i kërkesës, përmbledhja e kërkesës dhe dokumentacioni mbështetës i viktimës 12/06 do të vazhdojnë të mbajnë klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

D. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR I PËRBASHKËT

57. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se tre nga viktimat (viktimat 05/06, 22/06 dhe 26/06) kanë shprehur parapëlqimin e tyre për një mbrojtës konkret, tre dëshirojnë të kenë një mbrojtës ndërkombëtar/jo nga Kosova (viktimat 33/06, 37/06 dhe 40/06) dhe gjashtë nuk kanë ndonjë parapëlqim (viktimat 20/06, 34/06, 36/06, 38/06, 39/06 dhe 41/06).⁶⁴ ZPV-ja rekomandon që të gjitha VPP-të e pranuar të grupohen në Grupin 1, së bashku me viktimat e pranuar më parë, dhe që të gjitha të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave i caktuar për Grupin 1.⁶⁵

⁶³ *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 71.

⁶⁴ *Shih* Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 43; dhe formularët e kërkesës të secilës prej viktimave.

⁶⁵ KSC-BC-2020-06, F00241, VPO, *Shtesa e Raportit të Parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces me Rekomandim për Grupim*, 1 prill 2021, publike, me Shtojcën 1 konfidenciale dhe *ex parte*, para. 29; *Shtesa e Dytë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative*, para. 50; *Raporti i Dytë i Zyrës Administrative*, para. 42-44.

58. Bazuar në të njëjtat konstatime si ato të bëra në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,⁶⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 20/06, 22/06, 26/06 (në emër edhe të viktimës 05/06), 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 do të grupohen në Grupin 1, së bashku me VPP-të e pranuar më parë, dhe do të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave i caktuar për Grupin 1.

59. Pavarësisht nga kjo, me synimin për të garantuar efikasitetin e procesit dhe duke respektuar gjithashtu kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake inkurajon mbrojtësin e viktimave që të përfshijë mbrojtës të tjerë të propozuar ose caktuar, nëse është e mundur.

E. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

60. Viktimat 20/06, 22/06, 26/06 (në emër edhe të viktimës 05/06), 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 do t'i ushtrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet mbrojtësit të viktimave dhe do të marrin pjesë në proces sipas modaliteteve të përshkruara në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave.⁶⁷

F. ARSYETIM I MËTEJSHËM PËR VENDIMIN E GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE PËR REFUZIMIN E KËRKESAVE TË PARASHTRUESVE TË REFUZUAR

1. Vërejtje paraprake

61. Së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, siç është konfirmuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, krimet, viktimë e të cilave pretendon se është një

⁶⁶ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76; Vendimi i Parë Kornizë, para. 43.

⁶⁷ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82-84, 85(d).

parashtrues kërkesë, duhet të përfshihen brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar.⁶⁸ Për kryerjen e këtij vlerësimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton raportet e ZPV-së, formularët e kërkesës, dokumentacionin mbështetës dhe pjesët përkatëse të Aktakuzës së Konfirmuar të Korrigjuar, të cilat janë pika referimi për analizën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe duhen lexuar së bashku me arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Ndonëse çdo kërkesë vlerësohet individualisht, për të mundësuar një zhvillim të shpejtë dhe efikas të procesit, ky vlerësim nuk nënkupton domosdoshmërisht dhënien e arsytetimeve të veçanta për secilin parashtrues kërkesë, sidomos kur arsyet janë të njëjta ose të ngjashme.

62. Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të refuzuara ka paraqitur vërejtjet e saj në lidhje me dëmin e pësuar dhe ka kërkuar që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të rishqyrtojë vendimin e tij.⁶⁹ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paneli i Gjykatës së Apelit ia ka kthyer këtë çështje Gjykatësit të Procedurës Paraprake vetëm me qëllim që ai të japë arsye të mëtëjshme për refuzimin e kërkesave të parashtruesve.⁷⁰ Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të rishqyrtojë vendimin e tij të mëparshëm. Ai as nuk sheh ndonjë arsye për ta bërë këtë. Megjithatë, në mënyrë që parashtruesit e kërkesave të refuzuara të kuptojnë plotësisht arsyet për të cilat kërkesat e tyre u refuzuan, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'i trajtojë vërejtjet e tyre kur të paraqesë arsyet e mëtëjshme për vendimin e tij.

⁶⁸ Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 35; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 45.

⁶⁹ Vërejtje të Mbrojtësës së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, para. 1 dhe f. 6.

⁷⁰ Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40-41.

2. Arsyetim i mëtejshëm

(a) Viktima 08/06

63. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se viktima 08/06 pretendon se një anëtar i familjes së ngushtë të saj u rrëmbye [REDAKTUAR] dhe u mbajt nga anëtarë të UÇK-së në qendrat e ndalimit në [REDAKTUAR]. Ai mbetet i zhdukur edhe sot e kësaj dite.⁷¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) [REDAKTUAR] nuk figuron në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar si një vendndodhje ku kanë ndodhur krimet e përfshira në Aktakuzë; (ii) burgosja/ndalimi i pretenduar i viktimës së drejtpërdrejtë në [REDAKTUAR] nuk përfshihet brenda kuadrit kohor të akuzave në lidhje me këto vendndodhje;⁷² dhe (iii) viktima e drejtpërdrejtë nuk është ndër viktimat e pretenduara të zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar ose në Listën C. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se kuadri i akuzës për zhdukje me forcë kufizohet në incidentet konkrete të përshkruara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe në viktimat e identifikuar në të dhe në Listën C.⁷³

64. Duke mbajtur parasysh parashtrimin e bërë nga mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se për aktet e tjera çnjerëzore dhe trajtimin mizor nuk nevojitet një lidhje e qartë me vendndodhje konkrete,⁷⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar theksohet se “anëtarët dhe instrumentet e NKP-së krijuan dhe mbajtën kushte çnjerëzore në qendrat e ndalimit të identifikuar në Listën A”.⁷⁵ Rrjedhimisht, akuzat për akte të tjera çnjerëzore dhe trajtim mizor duhen lexuar së bashku me akuzat për

⁷¹ Viktima 08/06, SD1_Paraqitja e krimeve_ANG.

⁷² Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, [REDAKTUAR].

⁷³ Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendim në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 171.

⁷⁴ Vërejtje të Mbrojtësës së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, para. 7-8.

⁷⁵ Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, para. 94 (theksimi i shtuar).

burgosje/arrestim dhe ndalim arbitrar, të cilat pretendohet se janë kryer në një nga qendrat e identifikuara të ndalimit ose në një vendndodhje të identifikuar në mënyrë të ngjashme në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar dhe në Listën A.⁷⁶

(b) Viktimat 09/06, 10/06 dhe 11/06

65. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se viktimat 09/06, 10/06 dhe 11/06, të cilët janë anëtarë të të njëjtës familje, pretendojnë se anëtari i familjes së ngushtë të tyre u arrestua nga anëtarë të UÇK-së më [REDAKTUAR] dhe u mbajt i ndaluar në [REDAKTUAR]. Vendndodhja e tij mbetet e panjohur edhe sot e kësaj dite.⁷⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se arrestimi dhe ndalimi i pretenduar i viktimës së drejtpërdrejtë nuk përfshihet brenda kuadrit kohor të akuzave të përcaktuara në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar në lidhje me qendrën e ndalimit ku pretendohet se është mbajtur viktimja e drejtpërdrejtë.⁷⁸

66. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh parashtrimet e bëra nga mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se parashtruesit e kërkesave duhet të pranohen si VPP në bazë të dëmit që kanë pësuar si rezultat i (i) krimit të zhdukjes me forcë, duke pasur parasysh natyrën e tij të vazhdueshme, ose si alternativë (ii) krimeve të akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, të cilat nuk ka nevojë të jenë të lidhura me një qendër ndalimi të caktuar, ose (iii) përndjekjes, që shtrihet në të gjithë periudhën që përfshin Aktakuza.⁷⁹ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron se: (i) viktimja e drejtpërdrejtë nuk është ndër viktimat e pretenduara të zhdukjes me forcë, të përmendura me emër në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar;⁸⁰ (ii) akuzat për akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor janë të lidhura me qendrat e ndalimit të identifikuara në

⁷⁶ Vendim në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 150, 153.

⁷⁷ Viktimja 09/06, Formulari i kërkesës_ANG; Viktimja 10/06, Formulari i kërkesës_ANG; Viktimja 11/06, Formulari i kërkesës_ANG.

⁷⁸ Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, [REDAKTUAR].

⁷⁹ Vërejtje të Mbrojtëses së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, para. 9-11.

⁸⁰ *Shih* Aktakuza e Konfirmuar e Korrigjuar, Lista C.

Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar;⁸¹ dhe (iii) akuza e përndjekjes duhet lexuar së bashku me akuzat për burgosje/arrestim dhe ndalim arbitrar, akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë.⁸²

(c) Viktima 13/06

67. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se viktima 13/06 pretendon se i anëtari i familjes së ngushtë të tij u rrëmbye nga anëtarë të UÇK-së në [REDAKTUAR]. Familja mori vetëm informacione të përgjithshme se atë e kishin zhvendosur nga një qendër ndalimi në tjetrën dhe fati i tij mbetet i panjohur.⁸³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) informacioni i dhënë nuk mjafton për një konstatim *prima facie* se viktima e drejtpërdrejtë është mbajtur në një nga qendrat e ndalimit të identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar; dhe (ii) viktima e drejtpërdrejtë nuk është ndër viktimat e pretenduara të zhdukjes me forcë, të përmendura me emra në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar ose në Listën C.⁸⁴

(d) Viktima 14/06

68. Duke vënë në dukje se viktima 14/06 pretendon se anëtari i familjes së ngushtë të tij ishte viktimë e vrasjes së paligjshme,⁸⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se kuadri i akuzës për vrasje të paligjshme kufizohet në incidentet e përmendura shprehimisht në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar.⁸⁶ Vrasja e pretenduar e familjarit të viktimës 14/06, në bazë të informacionit të dhënë, nuk rezulton të jetë mes incidenteve për të cilat janë ngritur akuzat. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh parashtrimet e mbrojtëses së parashtruesve të

⁸¹ *Shih* para. 64 më lart.

⁸² Vendim në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 139, 144.

⁸³ Shtojca 14 e Raportit të Parë të Zyrës Administrative; Viktima 13/06, Formulari i kërkesës_ANG; SD3_Kronologjia e rrëmbimit_ANG; SD4.

⁸⁴ Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendim në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 171.

⁸⁵ Viktima 14/06, Formulari i kërkesës_ANG.

⁸⁶ Vendim në lidhje me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 160.

kërkesave të refuzuara,⁸⁷ akuza e përndjekjes duhet lexuar së bashku me akuzën për vrasje të paligjshme, siç u përmend më lart.⁸⁸

(e) Përfundim

69. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se krimet, viktimat të cilave pretendojnë të jenë viktimat 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06, nuk përfshihen brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar të Korrigjuar, dhe, rrjedhimisht, nuk përfshihen brenda fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores.⁸⁹

IV. VENDIM

70. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **REFUZON** kërkesën e viktimës 12/06 si të papranueshme;
- b. **MIRATON** kërkesat e viktimave 05/06, 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 dhe i pranon viktimat 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 për të marrë pjesë si viktimat në proces;
- c. **VENDOS** që viktimat 26/06 mund të vazhdojnë me kërkesën për praninë si VPP të parashtruar fillimisht nga viktimat 05/06 para Dhomave të Specializuara;
- d. **VENDOS** që viktimat 20/06, 22/06, 26/06 (në emër edhe të viktimës 05/06), 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 të përfshihen në Grupin 1 me qëllim përfaqësimin e përbashkët dhe të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave për Grupin 1;
- e. **VENDOS** që mbrojtësi i viktimave:

⁸⁷ Vërejtje të Mbrojtëses së Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara, para. 13.

⁸⁸ *Shih* para. 66 më lart.

⁸⁹ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 48.

- i. të ketë të drejtë të shohë të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, të klasifikuara publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes;
 - ii. të ketë të drejtë të njoftohet për të gjitha materialet e shpërndara në dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, nxjerrjet e materialeve provuese të klasifikuara si publike apo konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të shpërndara të dosjes së çështjes;
 - iii. të mos ketë të drejtë të shohë e të njoftohet për materialet rreptësisht konfidenciale, përfshirë parashtrime të protokolluara, transkripte apo materialet provuese, nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe;
 - iv. të mbajë të informuar viktimat pjesëmarrëse në proces për zhvillimet përkatëse të çështjes në mënyrë të tillë që të mos zbulojë informacione jopublike;
 - v. të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*; dhe
 - vi. të lejohet të bëjë parashtrime gojarisht dhe me shkrim, pa kërkuar leje paraprakisht, sa herë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces;
- f. **URDHËRON** që për viktimat 05/06, 20/06, 22/06, 26/06, 33/06, 34/06, 36/06, 37/06, 38/06, 39/06, 40/06 dhe 41/06 të miratohet masa mbrojtëse e anonimitetit sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores;
- g. **URDHËRON** që emri dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimës 12/06 të mos i bëhen të ditura palëve dhe publikut;

- h. **VENDOS** mbajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* për të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës;
- i. **URDHËRON** riklasifikimin si publik të parashtrimit të protokolluar F00318, aktualisht të klasifikuar si konfidencial; dhe
- j. **REFUZON** kërkesën për rishqyrtim të mbrojtëses së parashtruesve të kërkesave të refuzuara.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i procedurës Paraprake

E premte, 10 dhjetor 2021

Në Hagë, Holandë.